



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 02.09.2025

Numër Protokolli: 5985/2025

A.nr.967/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.967/2025 të datës 26.05.2025 të parashtruar nga ankuesi Y.S, kundër organit të punësimit: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.967/2025, e datës 26.05.2025, e parashtruar nga ankuesi Y.S.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 1271 të datës 28.04.2025, për kandidatin fitues i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, për pozitën “*Udhëheqës i Zyrës së Punësimit*” në Zyrën e Punësimit në Gjilan.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil Y.S (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 26.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me Nr. Reference RN00016662, për pozitën e punës ” *Udhëheqës i Zyrës së Punësimit*”, në Zyrën e Punësimit në Gjilan i shpallur nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (tutje APRK), ndërsa kjo e fundit, më datë 25.07.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit)
administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3478/2025 të datës 26.05.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e konkursit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 09.06.2025; Konkursin me numër reference RN00016662 të datës 10.02.2025; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 26.03.2025 për verifikim paraprak; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimi me numër protokolli 754 të datës 04.04.2025 dhe Akt emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Njoftimin për testin me shkrim i datës 18.04.2025; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 28.04.2025; Formularin e vlerësimit të esesë i datës 23.04.2025; Çelësin e Esesë; Njoftimin me numër protokolli 1271 të datës 28.04.2025 për kandidatin fitues; Aplikacionin e ankuesit i datës 11.03.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-52; Aplikacionin e datës 27.02.2025 të kandidatit P.V me dokumentacionin ,Aplikacionin e datës 10.03.2025 të kandidatit Y.S me dokumentacionin;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se APRK, më datë 10.02.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference RN00016662, për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Punësimit", në Zyrën e Punësimit në Gjilan, me afat aplikimi nga data 11.02.2025 deri me datë 12.03.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë njëmbëdhjetë punësë (11) kandidatë, ku prej tyre gjashtë (6) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, ndërsa ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë me arsyetimin se nuk e plotëson kriterin e përvojës së punës të përcaktuar në kriterin e konkursit.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në APRK, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht me datë 28.04.2024 ka publikuar Njoftimin me numër 1271 për kandidatin fitues për pozitën *Udhëheqës i Zyrës së Punësimit* në Zyrën e Punësimit në Gjilan, nga i cili njoftim rezulton se kandidati P.V, është kandidat fitues me gjithsej 91.4 pikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i njëjti i lotëson kriterin e përvojës së punës, i cili nga Këshilli kërkon rikthimin e procedurës në fazën e verifikimit paraprak.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me numër reference RN00016662, për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese *Udhëheqës i Zyrës së Punësimit*", në Zyrën e Punësimit në Gjilan dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushën: Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale apo Administratë Publike; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së së procedurës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publike, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje*

të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Tutje, me qëllim të shqyrtimit meritorisht të pretendimeve ankimore të parashtruar nga ankuesi, dhe konstatimit se kandidatët për emërimin në këtë pozitë të kategorisë së ulët drejtuese janë vlerësuar nga komisioni profesional, Kolegji i Këshillit, ka analizuar përbërjen e Komisionit të Pranimit dhe se nga analizimi i provave të lëndës, gjegjësisht bazuar në Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit me numër protokolli 754 të datës 04.04.2025, të Drejtoreshës së Përgjithshme të Agjencisë së Punësimit, ka konstatuar së përbërja e Komisionit, është në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara nga neni 45, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratë Publike, i cili përcakton se: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunës/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë. 3. Komisioni i pranimit zgjidhet adhoc për çdo pozitë nga lista e kandidateve/ëve potencial. Lista e kandidateve/ëve potencial për anëtarë të komisionit, miratohet nga Qeveria me propozim të ministres/it përgjegjës për Administratë Publike, ndërsa për institucionin tjetër shtetëror nga titullarja/i i institucionit përkatës dhe ka vlefshmëri për dy (2) vite, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës. 4. Komisioni i pranimit zgjidhet adhoc për çdo pozitë përmes sistemit kompjuterik nga njësia përgjegjëse. Komisioni emërohet nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ të institucionit; dhe në pajtim me nenin 22 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: 1. Komisioni i pranimit për vlerësimin profesional të kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese themelohet me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit që zhvillon procedurën e rekrutimit për institucionet e administratës shtetërore. Komisioni i pranimit në institucionin tjetër themelohet me vendim të titullarit të institucionit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunës civil nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë. 3. Për secilin nga kategoritë e anëtarëve të Komisionit, caktohet një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rastin e pamundësisë të përkohshme të anëtarit kryesor, kështu që komisioni i pranimit ka qenë i themeluar sipas kritereve ligjore.

Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim,

duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit ju referua Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenit 7 paragrafi 1, 2, 3, 4, , ku përcaktohet se: *Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.*

Tutje, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të kësaj procedure rekrutimit dhe duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuara ligjore, ka analizuar aplikacionin e kandidatit fitues P.V, të datës 27.02.2025, nga i cili rezulton se i njëjti si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me Nr.80 të datës 28.04.2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Ekonomik Qendra në Gjilan, me anë të cilës dëshmohet se i njëjti më datë 18.03.2015 ka mbaruar studimet themelore në Menaxhment dhe Informatikë dhe ka fituar titullin Bachelor për Menaxhment dhe Informatikë. Ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës tre (3) vjeçare të punës profesionale, kandidati në fjalë ka bashkangjitur Vërtetimin Sh 02Nr. 4676 të datës 27.02.2025 të lëshuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kamenicës, mbi të cilin dokument zyrtar dëshmohet se nga data 11.09.2017 deri më datë 01.09.2021 ka qenë në marrëdhënie pune në pozitën Zyrtar për Vlerësimin e peronës së Paluajtshme, ndërsa nga data 01.09.2021 vazhdon në pozitën në Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore në Komunën e Kamenicës dhe vazhdon të kryej punët dhe detyrat e pozitës përkatës, gjithashtu i njëjti ka bashkangjitur edhe një numër të konsiderueshëm të certifikatave nga kurset dhe trajnimet e përfunduara, si dhe licenca të lëshuar nga Institucionet Qendrore të Republikës së Kosovës. Kështu që Kolegji i Këshillit, mbi bazë të këtyre dokumenteve, vlerëson se kandidati fitues ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale si në aspektin e arsimimit po ashtu edhe në aspektin e përvojës së punës profesionale.

Po ashtu Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe aplikacionin e ankuesit z.Y.S të datës 10.03.2025 nga i cili rezulton se i njëjti si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me Nr.23 të datës 05.02.2019 të lëshuar nga Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan, Fakulteti Juridik, me anë të së cilës dëshmohet se i njëjti më datë 24.06.2017 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe mori titullin Bachelor në Juridik, LLB. Ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës tre (3) vjeçare të punës profesionale i njëjti prej datës 15.01.2018-15.01.2019 ka kryer praktikën në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2024 ka filluar të punojë në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ndërsa në pasqyrën e Trustit që ka sjell si dëshmi për periudhën 01.08.2002 - 28.02.2025 i njëjti është paguar edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve por për këtë nuk posedon as kontrat as vërtetim të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Përkitazi me këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se Njoftimi me numër protokolli 1271 të datës 28.04.2025, për kandidatin fitues i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në APRK, për pozitën “Udhëheqës i Zyrës së Punësimit” në Zyrën e Punësimit në Gjilan, është në pajtim të plotë me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 11 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i*

kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimiit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NJMBNJ, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat, kështu që Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, konstaton se Komisioni i Pranimiit dhe rrjedhimisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në APRK, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për sa më sipër, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.967/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Y.S;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në APRK; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.